



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
MINISTRIA E EKONOMISË

Në pajtim me Dekretin me fuqi ligjore për mbështetje financiare për forcimin e konkurrencës së subjekteve afariste gjatë dhe post periudhës COVID 19, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 153 e datës 09.06.2020), Ministria e Ekonomisë shpall:

**THIRRJE PUBLIKE**  
**për mbështetje financiare për forcimin e konkurrencës së subjekteve afariste gjatë dhe post**  
**periudhës COVID 19**

**1. Lënda e thirrjes publike** është të ofrojë mbështetje financiare për të forcuar konkurrencën e subjekteve afariste në mënyrë që të stabilizohet dhe rinovohet aktiviteti i tyre afarist, përfshirë kthimin e tregjeve të humbura, me çka do të mbahen sipërmarrjet afariste që do të kontribuojnë në rimëkëmbjen e ekonomisë vendore, përmes realizimit të projektit investues gjatë dhe në periudhën post-kovid për periudhën nga marsi i vitit 2020 deri në dhjetor të vitit 2021.

Në pajtim me Dekretin me fuqi ligjore për mbështetje financiare për të forcuar konkurrencën e subjekteve afariste gjatë dhe post periudhës COVID 19 (në tekstin e mëtejshëm: dekreti), janë parashikur mjete në shumë totale prej 1.200.000.000 denarë.

**2. Subjektet afariste që mund të shfrytëzojnë mbështetje financiare,**

janë subjekte afariste që:

- gjatë vitit 2020, kanë realizuar një projekt investues sipas planit të investimit;
- punojnë në sektorët e prodhimit që janë definuar si prodhim, në përputhje me Klasifikimin kombëtar të veprimtarive Rev.2, përveç atyre të përjashtuar nga kjo mundësi në përputhje me Ligjin për kontrollin e ndihmës shtetërore;
- kryejnë veprimtari tregtare, nëse investojnë në mjete themelore;
- kryejnë veprimtari nga fusha e shërbimeve informacionit dhe komunikimit, nëse investimi përfshin vendosjen e një njësie të re organizative për zhvillim teknologjik, hulumtim dhe / ose zhvillimin e një zgjidhje të re softuerike ose harduerike; dhe
- janë shfrytëzues të së drejtës për koncesion të mallrave me interes të përgjithshëm nëse koncesioni nuk përdoret për realizimin e një projekti investues;

**3. Subjektet afariste që nuk mund të shfrytëzojnë mbështetje financiare,**

janë subjekte afariste që:

- kanë treguar rezultat financiar negativ në vitin 2019;
- kryejnë veprimtari në fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit primar;
- kryejnë veprimtari ndërtimi lidhur me ndërtimin dhe shitjen e apartamenteve dhe ndërtesave të banimit dhe afariste për pjesën e veprimtarisë ndërtimi, ndërtimin dhe shitjen e apartamenteve, ndërtesave të banimit dhe ato afariste;
- punojnë në industrinë e prodhimit të qymyrit dhe çelikut;

- mbështeten nga masa dhe mekanizma të tjerë për mbështetjen e sektorëve të veçantë (siç janë sektori bankar, shërbimet financiare, dhe të ngjashme.);
- kryejnë veprimtari me interes publik të përcaktuara me ligj;
- kryejnë veprimtari të liçencuar;
- kryejnë veprimtari të rregulluar, çmimi i së cilës përcaktohet nga një organ rregullator i pavarur;
- janë shfrytëzues të së drejtës për koncesion të mallrave me interes të përgjithshëm;
- kryejnë veprimtari lidhur me prodhimin e dedikuar (armatim dhe pajisje ushtarake);
- prodhojnë mallra të akcizës, përveç mallrave të akcizës të destinuara për qëllime laboratorike farmaceutike, mjekësore dhe industriale dhe
- kryejnë veprimtari tregtare (me pakicë dhe shumicë), përveç nëse investojnë në mjete themelore dhe objekte.

#### 4. Lartësia e mbështetjes financiare

Lartësia e mbështetjes financiare është 25% e investimit të realizuar sipas planit të investimit, por jo më shumë se:

- 40.000 EUR në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës, për subjektet afariste që kanë realizuar gjithsej të ardhura në vitin 2019 jo më të larta se 1.000.000 EUR në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës;
- 100.000 EUR në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës, për subjektet afariste që kanë realizuar gjithsej të ardhura në vitin 2019 prej 1.000.001 EUR deri më 10.000.000 EUR në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës;
- 140.000 EUR në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës, për subjektet afariste që kanë realizuar gjithsej të ardhura në vitin 2019 prej 10.000.001 EUR deri më 50.000.000 EUR në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës; dhe
- 200.000 EUR në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës, për subjektet afariste që kanë realizuar gjithsej të ardhura në vitin 2019 më shumë se 50.000.000 EUR në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës.

Nëse, bazuar në parashikimin për llojin dhe shumën maksimale të mbështetjes financiare, tejkalohe mjetet e përcaktuara buxhetore, pagesa bëhet në përpjesëtim për shfrytëzues të mbështetjes financiare brenda buxhetit të përcaktuar.

## 5. Dokumentet për dorëzimin e Aplikacionit

Dokumentet e nevojshme për dorëzimin e Aplikacionit:

- formular të plotësuar – Aplikacion (mund të shkarkohet nga vebfaqja e Ministrisë së ekonomisë [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk))
- gjendja aktuale e subjektit afarist, jo më të vjetër se gjashtë muaj
- bilanci i suksesit për vitin 2019
- llogaritja e paradhënieve të tatimit mbi fitimin për muajt mars, prill dhe maj të vitit 2020
- plani investues план (mund të shkarkohet nga vebfaqja e Ministrisë së ekonomisë [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk))
- deklaratë e noterizuar e përfaqësuesit ligjor të shfrytëzuesit, nën përgjegjësinë e plotë materiale, penale dhe morale që dokumentacioni dhe të dhënat e paraqitura janë të sakta, të vërteta dhe të besueshme

## 6. Mënyra dhe afati i dorëzimit të Aplikacionit

Kërkesat së bashku me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohen në zarf të mbyllur në Arkivin e Ministrisë së ekonomisë, rr. "Jurij Gagarin" nr. 15, Shkup, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në orën 15:00.

Në zarf duhet të qëndrojë :

Për Ministrinë e ekonomisë, Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve të subjekteve afariste, adresa: rr. Jurij Gagarin 15, 1000 Shkup

Për Thirrjen Publike për mbështetje financiare për të forcuar konkurrencën e subjekteve afariste gjatë dhe në posti periudhën COVID 19 me shënim "MOS E HAP".

Afati i fundit për të aplikuar për këtë thirrje publike është deri më 31.07.2020.

## 7. Shqyrtimi i aplikacioneve dhe lidhja e marrëveshjeve

Aplikacionet për mbështetje financiare do t'i shqyrtojë Komisioni i formuar nga Ministri i ekonomisë.

Subjektet afariste që do të marrin mbështetje financiare lidhin Marrëveshje me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Subjekti afarist që do të marrë mbështetje financiare është i detyruar ta sigurojë kontratën me Kambial. Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare, kambialin e siguron me deklaratë kambiali për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve në formën e një akti noterial me një klauzolë ekzekutive.

Kambiali me të cilin garantohet mbështetja duhet të jetë e vlefshme të paktën 60 ditë më shumë se data e dorëzimit të raportit përfundimtar.

## 8. Pagesa e mjeteve

Pagesën e mjeteve për mbështetje financiare do ta bëjë Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga mjetet e parashikuara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 në programin P1 Masat për ballafaqimin me COVID 19.

## 9. Dorëzimi i Raportit

Subjekti afarist që i është ndarë dhe paguar mbështetje financiare, është i obliguar nga data 31.01.2021 deri më 31.12.2021 t'i dorëzojë Ofruesit të mbështetjes financiare një Raport mbi rrjedhën e realizimit të planit të investimit me dëshmi në formën e dokumentacionit financiar dhe dokumentacionit tjetër, i përshtatshëm për projektin e investimit. në përputhje me nenin 13 paragrafi 3 të Dekretit se i njëjti është realizuar në suaza të planit të investimit për të cilin është paguar mbështetja financiare.

Nëse subjekti afarist nuk ka përfunduar investimin deri më 31.12.2020, atëherë dorëzon një raport përfundimtar, dorëzon një raport për progres me dokumentet e mëposhtme:

- Për blerjen e mjeteve themelore, pajisjeve dhe makinerive dorëzon një marrëveshje ose faturë me dëshmi për pagesë të plotë ose të pjesshme ose akreditiv të hapur alternativ ose garanci bankare të lëshuar për të. Mjetet themelore, pajisjet dhe makineria nuk duhet të jenë më të vjetra se dy vjet.
- Për ndërtimin e sallave të prodhimit, dorëzon një leje ndërtimi të lëshuar me përlllogaritje matëse, dëshmi të pagesave të bëra për ndërtimin dhe foto dokumentacionin për të njëjtën. Dokumentacioni duhet të jetë në emër të kompanisë që aplikon për mbështetje financiare.
- Për të krijuar një njësi të re organizative për zhvillim teknologjik, hulumtim dhe / ose zhvillimin e një zgjidhje të re softuerike apo harduerike, dorëzon raporte evidentuese përmjetet e investuara në pajisje, investime në kapitalin operativ, trajnime dhe / ose marrëveshje për pronësi intelektuale.

Ministria e Ekonomisë kontrollon procesin e zbatimit dhe saktësinë e raportit përfundimtar.

Nëse subjekti afarist nuk arrin të kryejë investimin ose nuk arin të dëshmojë të paktën 80% të vlerës së investimit, ai duhet të kthejë mjetet në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut jo më vonë se 01.03.2022, në të kundërtën ofruesi i ndihmës financiare do ta aktivizojë kambialin si mekanizëm sigurie.

